



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2190/I prot.

Tiranë, më 01.12.2023

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektligj

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 21588 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2190 prot., datë 30.11.2023, përmes së cilës dërgohet për mendim projektligji “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Çertifikatat e Mbrojtjes Shtesë”, shoqëruar nga relacioni shpjegues, RIA dhe tabelat e përputhshmërisë më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit dhe dokumenteve shoqëruese vërejmë se me këtë projektligj synohet përafrim i plotë me Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian si dhe janë marrë për model legjislacionet e fundit të shteteve evropiane në fushën e patentave.

Sa i përket parashikimeve për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit konstaton se është bërë një harmonizim i plotë me nenet përkatëse të *acquis communautaire*.

Për sa më lart, në tërësi projektligji vlerësohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

